L I G J
Nr.9107, datë 17.7.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8636, DATË 6.7.2000 "PËR ZONAT E LIRA", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8725, DATË 26.12.2000

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira", ndryshuar me ligjin nr.8725, datë 26.12.2000 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pikat 1 dhe 2 të nenit 4 ndryshohen si më poshtë:

"1. Në bazë të studimeve rajonale dhe të zhvillimit ekonomik të vendit, Enti, i mbështetur në vendimin e këshillit drejtues, i paraqet ministrit që mbulon ekonominë propozimin për krijimin e një zone të lirë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon ekonominë miraton rast pas rasti shpalljen e një zone të lirë.".

Neni 2

Pika 4 e nenit 6 ndryshohet si më poshtë:

"4.Enti është institucion qendror, në varësi të ministrit që mbulon ekonominë.".

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7

1. Këshilli drejtues i Entit përbëhet nga 7 anëtarë dhe kryesohet nga ministri që mbulon ekonominë. Drejtori ekzekutiv emërohet nga ministri që mbulon ekonominë.

2. Këshilli drejtues përbëhet nga:

a) zëvendësministri që mbulon ekonominë;

b) zëvendësministri që mbulon financat;

c) zëvendësministri që mbulon veprimtarinë e industrisë;

ç) Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;

d) Kryetari i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;

dh) Drejtori Ekzekutiv i Entit Kombëtar të Zonave të Lira.".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3921, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu